



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshor

Kryesia e Kuvendit

P-046

Prishtinë, më 23 nëntor 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 NËNTOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Slavko Simiq.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës. Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë: 1. Kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Shqipëri.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 16 nëntor 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 16 nëntor 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 16 nëntor 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se sot, më 23 nëntor 2015, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka proceduar për seancë plenare Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për sigurimet, projektligj i cili i plotëson kushtet për ta radhitur për shqyrtim në seancë plenare.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin lidhur me përgatitjet për seancën plenare të radhës.

Lidhur me përgatitjet dhe mbarëvajtjen e seancave plenare, si dhe krijimin e kushteve të sigurisë për deputetët e Kuvendit diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Adem Grabovci, kryetar i GP të PDK-së dhe Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, lidhur me situatën e krijuar në Kuvend dhe bllokadën që po e shkakton opozita gjatë mbajtjes së seancave plenare kërkoi nga nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, që të diskutojë edhe një herë me deputetët e grupeve parlamentare të opozitës për zhblokimin e seancave plenare. Nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, duhet ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për qëndrimet e opozitës para mbajtjes së seancës plenare.

Më pas, Kryesia vendosi që më 30 nëntor 2015, në orën 09:00, të mbahet edhe një mbledhje e Kryesisë për ta vlerësuar paraprakisht përgjigjen e grupeve parlamentare të opozitës për mbajtjen e seancës plenare. Duhet krijuar kushte normale për mbajtjen e seancës plenare, duke e zbatuar Rregulloren e Kuvendit, ligjet dhe Kushtetutën për të funksionuar normalisht Kuvendi.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pesë vota për dhe një kundër (Aida Dërguti) vendosi që seanca plenare të mbahet të hënën, më 30 nëntor 2015, me fillim në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut,*
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: "KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës",*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194,*
- 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237,*
- 8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,*
- 9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar,*
- 10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës,*
- 11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,*
- 12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,*
- 13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mjekësinë ligjore,*
- 14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patentë shofer,*
- 15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës,*
- 16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë,*
- 17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,*
- 18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet,*
- 19. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,*
- 20. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
- 21. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të Posaçëm për zgjedhjen e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,*
- 22. Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,*
- 23. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,*
- 24. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës,*
- 25. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014,*
- 26. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015,*
- 27. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër,*

28. *Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014,*
29. *Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane për vitin 2014,*
30. *Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014,*
31. *Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014,*
32. *Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit,*
33. *Kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës për dhënien e pëlqimit për rinovimin e sheshit “Adem Jashari” në Prishtinë,*
34. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
35. *Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare.*

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Procedimi i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për siguri në punë në veprimtarinë minerare t’u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funkcional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

2. Kërkesa për emërimin e kryetarëve dhe nënkryetarëve të grupeve të miqësisë

Kryesia e u shtyu pikën e lartshënuar për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel (Belgjikë)

Kryesia nuk e miratoi kërkesën e deputetit të Kuvendit, z. Qerim Bajrami, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel (Belgjikë).

4. Njoftimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me vizitat zyrtare të realizuara në Shqipëri dhe në Mal të Zi

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me vizitat zyrtare të realizuar në Shqipëri prej 4-6 tetor 2014, si dhe në Mal të Zi, prej 25-27 tetor 2015.

5. Njoftimi i nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, për pjesëmarrjen në Konferencën e njëmbëdhjetë të komisioneve parlamentare për çështje evropiane të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Evropës Juglindore - "COSAP"

Kryesia u njoftua me raportin e nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, lidhur me pjesëmarrjen e tij në Konferencën e njëmbëdhjetë të komisioneve parlamentare për integritet/çështje evropiane të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Evropës Juglindore-"COSAP", e cila është mbajtur në Shqipëri prej 22-24 tetor 2015.

Pika shtesë:

1. Kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri, prej 30 nëntor deri më 2 dhjetor 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi i anëtareve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në këtë përbërje: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxheri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka në Shqipëri, prej 30 nëntor deri më 2 dhjetor 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 13:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale